

VENDIM
Nr. 122, datë 19.6.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FU-GEN” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 886/18 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Fu-Gen’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “FU-GEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 4.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 62, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencim e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 886/3 prot., datë 22.4.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende në aplikimin e saj.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 1030 prot., datë 2.5.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë.

- Shoqëria me shkresën nr. 886/4 prot., datë 2.5.2024, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Fu-Gen” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 886/6 prot., datë 22.5.2023, është njoftuar shoqëria për zhvillimin e një seance dëgjimore, në lidhje me dokumentacionin e mbetur ende të pa plotësuar.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 886/7 prot., datë 27.5.2024 dhe nr. 886/8 prot., datë 29.5.2024, nr. 886/11 prot., 886/12 prot., datë 6.6.2024, 886/13 prot., datë 7.6.2024 dhe 886/15 prot., datë 12.6.2024.

- Me vendimin nr. 114, datë 10.6.2024, Bordi i ERE-s, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Fu-Gen” sh.p.k., për arsye të sqarimit/rakordimit të shumës së financimit në referencë të asaj që është përcaktuar nga kontrata më MIE-n dhe për të saktësuar afatin e fillimit të operimit duke qenë se data 1.6.2024 ka kaluar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886/17 prot., datë 13.6.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion shtesë të aplikimit.

- Nga analizimi i dokumentacionit në referencë të përcaktimeve, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin sa kërkuar në nenin 9, pika 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”.

- Rezulton se shoqëria “Fu-Gen” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2425 rep., nr. 1570 kol., datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier nga shoqëria ‘Fu-Gen’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes, nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. nr. 6357/3 prot., datë 28.6.2022;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprak, lëshuar më 10.6.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit PV Fier”, me vendndodhje në Topojë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për fuqinë e instaluar 2 mw.

- Centrali fotovoltaiik parashikohet që të fillojë operimin në muajin shtator të vitit 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Fu-Gen” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Fu-Gen” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti